REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	17.05.2022
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor - Maj 2022

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.05.2022 deri 31.05.2022.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN MAJ 2022

1. Përmbledhje ekzekutive

Është shënuar Viti i Përsonave me Aftësi të Kufizuara, përmes lëshimit në përdorim të Ashensorit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan. Ky projekt ka rëndësi të veqantë për përsonat me aftësi të kufizuara ngase ju ofron qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore në katin e dytë dhe të tretë në QKMF.

Kuvendi Komunal ka aprovar Strategjinë për Përfshirje Sociale 2022-2024 dhe Planin e Veprimit për implementim të kësaj strategjie. Të gjitha procedurat ligjore janë respektuar, si mbajtja e dëgjimeve publike, konsultimi me komitetet relevante të Kuvendit Komunal dhe konsultimet me OJQ.

Në këtë muaj i kemi dhënë theks të veqantë kujdesit të integruar shëndetësor dhe shërbimeve preventive si: kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeqare.

Projektet kapitale janë shpallur dhe janë në procedura të prokurimit. Lista e projekteve në procedure është si vijon:

- Renovimin e Tualeteve në QKMF Lipjan,
- Shtruajraj e Dyshemesë me EPOKSIT në QKMF Lipjan,
- Renovimi i QKMF Lipjan Faza II
- Renovimi QMF Shalë dhe QMF Magure.
- Furnizim me Aparatura Mjeksësore për QKMF Lipjan.

Është duke vazhduar ofrimi i shërbimit të vaksinimit kundër Covid19.

Furnizimi i brendshëm me material mjekësor dhe laboratorik është kryer me rregull, sipas kërkesave nga shefat e sektorëve. Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë me insulinë dhe barna për hipertension është duke u përcjellë me vështërsi, vonesa dhe mungesa.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara bazuar në Planit e Punës së DHSPS-së për vitin 2022

Ne këtë muaj jemi angazhuar në implementimin e shërbimeve shëndetësore të integruara. Me 27.05.2022 është mbajtur një punëtori, e organizuar nga AQH, rreth implementimit të shërbimeve të integruara shëndetësore.

Kemi marrë pjesë në Konferencën e 22-të Ndërkombëtare për Shërbime te Integruara ICIC22, organizuar në Odense-Danimarkë.

Kontrata për furmizim me oksigjen është në procedura të prokurimit dhe pritet të lidhet së shpejti.

Webfaqja e QKMF-së është në finalizim e sipër. Brenda web faqes do të adresohet objektivi 1.f. Zhvillimi dhe implementimi i kutisë elektronike të ankesave në QKMF, QMF, AMF dhe urgjencë.

Në këte muaj jemi angazhuar në krijimin e mundësive për themelimin e këshillit të pacientëve. Me organizatën PRAK, mbështetur nga AQH, kemi mbajtur takim dhe kemi diskutuar modalitetet dhe mundësitë e themelimit të këtij këshilli. Qëlimi i themelimit të këshillit të pacienteve është marrja e kontributit nga pacienti për avancim të mëtutjeshëm të shërbimeve mjekësore.

Me AQH-në kemi mbajtur takim dhe jemi pajtuar që të bashkëfinacohet projekti Renovimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Gadime nga Komuna dhe AQH. Kontributi i AQH-së në këtë projekt është 100,000.00€, ndërsa pjesa tjetër do të mbulohet nga Komuna e Lipjanit.

Përgatitjet për pilot projektin menaxhimi i sistemit të radhës, kanë vazhduar nga donator. Është duke u punuar në program dhe ndërlidhje me panelet visuale.

Kemi filluar të punojmë në planin për riorganizimi i ordinancave. Ky riorganizim ka për qëllim organizimin më të mirë të punës, krijimin e kushteve për mjeket dhe infermierët si dhe krijimin e mundësive për dhënje të shërbimeve më të mira mjekësore. Ky riorganizim do të mundësoj implementimin e nënobjektivit 1.d. Riorganizimi i ordinancave brenda QKMFs.

Në takimin e mbajtur në këtë muaj, nga OJQ POLIS është raportuar rreth Fletë Notimit Komunitar ku janë diskutuar aktivitetet dhe masat për implementimin dhe realizim e aktiviteteve brenda afateve kohore të caktuara.

3. Vaksinimi i rregullt dhe kundër Covid19

Numri total i të vaksinuarëve, që nga fillimi i vaksinimit me vaksinën anti-Covid19 deri në fund të muajit Maj 2022, është 61,802. Të vaksinuar me dozën e parë janë 31,840, me dozën e dytë 27,553 ndërsa me dozën e tretë 2,409.
Gjatë muajt Maj janë vaksinuar 112 qytetar. Më dozën e parë janë vaksinuar 30, me dozën e dytë 41 ndërsa me dozën e tretë janë vaksinuar 41 qytetar.
Edhe gjatë këtij muaji ka vazhduar vaksinimi i qytetarëve me vaksinën anti-Covid-19 në shtëpi, Qendrën e Azilit në Magure dhe në shkolla.
Kemi vazhduar me zbatimin e masave të rekomanduara nga MSH dhe IKSHPK për pandeminë Covid-19 dhe kemi qenë në koordinim me akterët relevant në Komunën e Lipjanit për zbatimin e masave të rekomanduara.

4. Testimet kunder Covid19

Numri i rasteve me Covid-19, të infeksioneve me virusin Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shënuar rënie edhe gjatë muajit Maj 2022.
Numri i përgjithshëm i tesimeve në muajin Maj 2022 ka qenë 171. Numi i të testuarve me rezultat pozitiv ka qenë 9.

5. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF, Qendra të Mjekësisë Familjare QMF dhe Ambulata të Mjekësisë Familjare AMF gjatë muajit Maj janë kreyr 35974 vizita dhe shërbime mjekësore.
Në muajin Maj kanë qenë gjithsejt 32 aksidente trafiku.

Tabela.1 Vizitat mjekësore të ofruara në të gjithë sektorët e QKMF-së, QMF dhe AMF.

01	Vizita mjeksore nga Mjeku Familjar(MF)/Mjeku i Përgjitëshëm(MP) në QKMF	7460
02	Vizita mjeksore nga MF/MP në Punkte	3000
03	Vizita në shërbimin e urgjencës	3777
04	Vizita në shërbimin e stomatologjisë	500
05	Vizita në shërbimin e gjinekologjisë/maternitet	396
06	Vizita në shërbimin e pediatrisë	404
07	Vizita në sherbimin e pulmologjisë	40
08	Vizita në kujdesin paliativ	92
09	Gjithsejt vizita mjekësore	15669

Tabela 2. Shërbimet shëndetësore të ofruara në të gjithë sektorët e QKMF-së, QMF dhe AMF.

10	**Gjithsej injekcione**	**7362**
11	Gjithsej infuzjone	**3019**
12	Gjithsej lidhje-pasrim plage	**1585**
13	Gjithsej Rtg exponime	**349**
14	Gjithsej pacient ne laborator	**1848**
15	Gjithsej lindje	**0**
16	Gjithsej EKG	**447**

17	Gjithsej Mamografi	**0**
18	Gjithsej USG	**99**
19	Gjithsej vizita shtepijake	**57**
20	Gjithsej transport me autoambulancë	**115**
21	Gjithsej Imobilizime	**67**
22	Gjithsej Oksigjenoterapi	**118**
23	Gjithsej Largim i Penjëve	**109**
24	Gjithsej aksidente trafiku	**32**
25	Këshillimorja	**85**
26	Gjithsej referime	**1936**
27	Gjithsej vakcina	**670**
28	Gjithsej sherbime	**18005**
29	**Perqindja e referimeve**	**11.33%**

6. Qendra për Punë Sociale QPS

Tabela 3. Shërbimi Social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët	**Numri i rasteve**	**Shërbimet**	**Numri i rasteve**
Klientët të cilët kërkojnë fëmijë për strehim familjar.	/	Shërbimet për të rritur me aftësi të kufizuara	/
Të mitur në konflikt me ligjin	19	Shërbime për të moshuarit	/
Fëmijë me sjellje asociale	12	Shërbimet për të rriturit në konflikt me ligjin	30
Martesa e të miturve që dëshirojnë të hyjnë në martesë	1	Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore	2
Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar	1	Intervenim i viktimave	8
Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore	/	Alimentacion	/
Viktimat e dhunës në familje	8	Këshilla psiko-sociale	6
Klient me aftësi të Kufizuara-Fëmijë	3	Kujdestaria	
Klientë në nevojë për këshillime martesore	3	Intervenimet e përgjithshme	225
Viktimat e krimeve seksuale	2	Mbajtja e kujdestarisë 24/7	14

Klient me aftësi të kufizuar- Të rriturit	/	Këshillim për bashkëshortët në martesë	4
Të moshuarit në nevojë për shërbime	/	Shërbimi për fëmijë me aftësi të kufizuar	15
Klientë tjerë në nevojë për shërbime	20	Sanim i marëdhënieve familjare	/
Fëmijë i braktisur	1	Përfaqësues të përkohshëm	10
Viktimat e trafikimit	1	Viktima të vendosura në strehimore-viktima të dhunës në familje	2
		Bashkim familjar, kthimi në familje	1
Total	**75**	**Numri i përgjithshëm i shërbimeve**	**317**

Tabela 4. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	**Kategoria 1**	**Kategoria 2**	**Kategoria 3**
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë	3	5	8
	1.1.Sa prej tyre janë aprovuar	1	3	4
	1.2.Sa janë në shqyrtim	2	2	4
	1.3.Sa prej tyre janë refuzuar	0	0	0
RIAPLIKIMI	2.Numri i rasteve të larguara për mos riaplikim	3	3	6
	2.1.Numri i rasteve që kanë aplikuar	51	65	116
	2.2 Numri i rasteve të larguara për mungesë të dokumentacionit	2	3	5
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/riverifikuara	5	7	12
	3.1.Sa prej tyre janë aprovuar	5	8	13
	3.2.Sa prej tyre janë refuzuar cregjistruar	1	4	5
KOMISIONI MJEKËSOR	4.Numri i rasteve të dërguara në komision mjekësor	28	0	28
	4.1.Numri i rasteve të aprovuara nga KM	13	0	13
	4.2.Numri i rasteve të refuzuara nga KM	13	0	16
	4.3.Numri i rasteve të kthyera nga KM për kompletim dokumentacioni	2	0	2
ANKESAT	5. Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit	5	3	8
	a) Në shkallë të parë (I)	0	0	0
	b) Në shkallë të dytë (II)	5	3	8
	Numri i ankesave të aprovuara	0	0	0
	Numri i ankesave të refuzuara	0	0	0
	Numri i ankesave në shqyrtim	5	3	8
	Kontestet në gjykata	0	0	0
	a) Konteste të pranuara	0	0	0
	b) Konteste të refuzuara	0	0	0

Aktivitetet:

- Punë administrative dhe me palë.
- Takim me stafin rreth mbarëvajtjes në punë dhe orientim të shërbimeve.
- Takime ne Komunë me komunitetin për fëmijë që kanë braktisur shkollimin.
- Hartimi dhe Dërgimi i planit buxhetor për tre vitet e ardhshme.

7. Shtëpia me Bazë në Komunite

Në këtë muaj rezidentët dhe stafi i Shtëpisë me Bazë në Komunitet janë dërguar për qëndrim javorë në Prevallë.
Kërkesa për hartimin e paramasës dhe parallogarisë për instalim të ujësjellësit është bërë që nga muaji Mars i këtij viti.

8. Investimet Kapitale

Janë duke u zhvilluar procedurat e prokurimit për projektet si vijon:

- Renovimi i QKMF-së,
- Renovimi i tualeteve në QKMF,
- Rregullimi i dyshemesë me epoksit në QKMF,
- Renovimi I QMF Shalë dhe Magure,
- Blerja e aparaturave mjekëesore,
- Blerja e Autoambulancve.

9. Vështërsitë dhe sfidat

Mungesa e automjeteve të përshtatshme për bartjen e pacienteve me dializë.
Mungesa e automjetit për këshillimore.
Numri i madh i pacientëve për marrjen e shërbimeve dhe vizitave mjekësore, trajtimi me infuzione dhe ineksione.
Furnizimi i pjesërishëm me barna dhe materiale mjekësore nga Ministria e Shëndetësisë dhe mungesa e insulinës.

10. Planifikimi për muajin Qershor 2022

Përgatitjet për rritjen e numrit të shërbimeve mjekësore dhe riorganizimi i stafit për shkak të ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora.
Vizitë studimore në Lubljane-Slloveni, 19-23 Qershor 2022.
Riorganizimi i ordinancave.
Zbatimi i planit të veprimit për vaksinimin me vaksinat anti-Covid-19.
Vazhdimi i implementimit të projektit me AQH-në për Qendër Demostruese QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me Solaborate rreth pilot projektit sistemi elektronik i rendit.
Takime konsultative dhe trajnime të stafit për pilot projektin e telemjekësisë.
Zbatimi i planit të veprimit për vitin 2022 dhe implementimi i shërbimeve të integruara.